

Vizitë studimore në Gjykatën Turke të Llogarive për shkëmbimin e eksperiencave në auditimin e kontratave koncensionare dhe te partneritetit publik privat (PPP)

Në kuadër të zbatimit të fazës së fundit të implementimit të projektit "Forcimi i Mbikëqyrjes së Auditimit të Jashtëm për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat (PPP) në Shqipëri" financiar nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), 20 auditues të KLSH-së vizituan në datat 3 dhe 4 dhjetor Gjykatën Turke të Llogarive (TCA). Qëllimi i kësaj vizite studimore ishte shkëmbimi i eksperiencës së TCA në auditimin e kontratave koncensionare dhe të partneritetit publik privat (PPP). Sipas axhendës së bashkëmiratuar audituesit e KLSH-së i prezantuan kolegëve produktet e projektit nëpërmjet prezantimeve të metodologjisë së krijuar dhe tre auditimeve të realizuara me asistencën e ekspertëve të jashtëm, si dhe u njohën me eksperiencën dhe metodologjinë e tyre në auditimin e kontratave koncensionare.



Për ta konkretizuar edhe më shumë këtë ekspertizë u zhvillua një vizitë me të gjithë përfaqësuesit në qytetin spitalor Etilik, një ndër tre spitalet më të mëdhenj në botë, si një nga kontratat koncensionare më të mëdhaja të partneritetit publik privat në Turqi, në vitin e 3 të zbatimit të saj.

Delegacioni i audituesve u mirëprit nga Presidenti i TCA, Z.Metin Yener, i cili e përshëndeti takimin edhe në ditën e dytë të punimeve.



Gjithashtu nën mbështetjen dhe kujdesin e kolegëve të TCA u zhvilluan edhe një sërë aktiviteteve sociale në kohën e lirë si vizita në Anitkabir (Memoriali M.Q.Ataturk), në kështjellën e Ankarasë, Asamblenë e I dhe II të qeverisë turke dhe pallatin e Ankarasë.

